

VENDIM
Nr. 323, datë 6.5.2026

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE QË NDIQEN PËR FINANCIMIN E
PROJEKTEVE ARTISTIKE E KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim miratimin e procedurave që ndiqen për financimin e realizimit të projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, referuar pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar.

2. Për të përfutur mbështetje financiare, projektet dhe veprimtaritë artistike kulturore duhet:

- a) të promovojnë artin dhe kulturën;
- b) të nxisin krijimtarinë dhe inovacionin artistik;
- c) të mbështesin zhvillimin dhe shpërndarjen e veprimtarive kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- ç) të kontribuojnë në ruajtjen dhe pasurimin e paketës kulturore brenda vendit.

3. Projekt artistik/kulturore është tërësia e veprimtarive që lidhen drejtpërdrejt me konceptimin, prodhimin dhe realizimin e një krijimi ose aktiviteti artistik, për të cilin angazhohen produkte dhe punime të nevojshme për realizimin e tij, dhe që synon promovimin e artit e të kulturës.

II. PROCEDURAT E ORGANIZIMIT DHE TË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE DHE VEPRIMTARIVE ARTISTIKE E KULTURORE

1. Projektet artistike/kulturore, të iniciuara nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, ose subjekte private, financohen nga fondi përkatës, vetëm në masën dhe për aq sa lidhen drejtpërdrejt me krijimin dhe realizimin e projektit artistik.

2. Në kuadër të realizimit të projektit artistik/kulturore, sigurohen produkte, të lidhura drejtpërdrejt dhe në mënyrë funksionale me konceptimin, prodhimin dhe realizimin e projektit artistik/kulturore, në përputhje me parimet e eficiencës ekonomike, efektivitetit dhe përdorimit të drejtë të fondeve publike.

3. Struktura përgjegjëse për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive artistike në fushën e artit e të kulturës, në ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën, përgatit informacion për iniciativën konkrete dhe, pas miratimit nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, ngrihet kolegji, sipas nenit 27, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, përgjegjës për ndjekjen e procedurave të vlerësimit dhe përzgjedhjes së subjekteve për lidhjen e kontratave:

a) me entitete kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë ekskluzivitetin për realizimin e projekteve dhe veprimtarive artistike kombëtare e ndërkombëtare në fushën e artit dhe kulturës;

b) me subjekte që ofrojnë produkte dhe shërbime, në funksion të projekteve dhe veprimtarive kombëtare e ndërkombëtare në fushën e artit dhe kulturës.

4. Procedura për lidhjen e kontratave, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të këtij kreu, kryhet, si më poshtë vijon:

a) Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën paraqet letrën e shprehjes së interesit për subjektin/entitetin pritës së projektit/veprimtarisë artistike;

b) Struktura përgjegjëse për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive artistike në fushën e artit dhe kulturës në ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën koordinon dhe zhvillon komunikimet për organizimin;

c) Kolegjiumi shqyrton propozimet e paraqitura dhe përzgjedh ofertën më të favorshme, ndërmjet cilësisë së shërbimit dhe kostos financiare, të cilin ia propozon për miratim ministrit;

ç) Ministri apo personi i autorizuar prej tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përzgjedhja e ofertës më të favorshme, lidh kontratën me subjektin apo filialet e autorizuar nga mbajtësi i së drejtës ekskluzive të projektit dhe/apo veprimtarisë artistike e kulturore;

d) Pagesat për kontratat urdhërohen nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ekzekutohen nëpërmjet strukturës së thesarit.

5. Procedura për lidhjen e kontratave, sipas shkronjës “b”, të pikës 3, të këtij kreu, kryhet, si më poshtë vijon:

a) Ftesa për shprehje interesi, në përputhje me objektin e kontratës, u paraqitet të paktën tri subjekteve, të cilat duhet të shprehen zyrtarisht brenda 5 (pesë) ditëve nga data e ftesës;

b) Struktura përgjegjëse për artin dhe kulturën harton kriteret e termat e referencës dhe përllogarit fondin limit;

c) Ftesa për propozim u paraqitet të paktën tri subjekteve, sipas afateve dhe kriterëve për kualifikim;

ç) Afati për pranimin e propozimeve është 7 (shtatë) ditë nga data e ftesës për propozim;

d) Kolegjiumi, brenda 3 (tri) ditëve nga dorëzimi i propozimeve të paraqitura, vlerëson dokumentacionin dhe përzgjedh subjektin fitues, të cilin ia propozon për miratim ministrit;

dh) Ministri apo personi i autorizuar prej tij lidh kontratën me subjektin e përzgjedhur brenda 3 (tri) ditëve nga njoftimi i fituesit.

6. Në rastin e projekteve dhe veprimtarive artistike, të cilat kanë shtrirje brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procedura nis me publikimin e thirrjes publike në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën. Pas përfundimit të afatit të publikuar, procedura zhvillohet sipas këtij kreu. Vlerësimi kryhet nga Kolegjiumi, si dhe nga një juri e përbërë nga ekspertë të fushës, vendës ose të huaj, me jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Përbërja nominale e jurisë përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

7. Projektet artistike, sipas pikës 6 të këtij kreu realizohen dhe ndiqen në përputhje me marrëveshjen e lidhur ndërmjet ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe subjekteve juridike brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

8. Në rastet kur natyra e tyre kërkon përfshirjen e individëve me profil të veçantë artistik ose ekspertizë të specializuar, përzgjedhja e artistëve, kuratorëve, drejtuesve artistikë, koordinatorëve dhe stafit krijues realizohet nëpërmjet thirrjes publike dhe negocimit.

9. Negocimi bazohet në:

a) vlerësimin e portofolit dhe të përvojës profesionale;

b) përshtatshmërinë me konceptin artistik të projektit;

c) kontributin në projekte të ngjashme.

10. Monitorimi i zbatimit të kontratave dhe realizimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore kryhet nga përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën, të cilët përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

11. Vendimi nr. 306, datë 11.5.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që ndiqen për financimin e projekteve artistike”, shfuqizohet.

12. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama